



Një mundësi edukimi për gjeneratën e ardhme të udhëheqësve kosovarë

Cka është Fondi Kosovaro-Amerikan për Edukim (KAEF)?

- KAEF u ofron bursa për në universitetet amerikane, kosovarëve të talentuar të cilët tregojnë përkushtim në zhvillimin ekonomik të shtetit të tyre.
- Investimi në KAEF do të rezultojë në zhvillim afatgjatë dhe mundësi më të mira punësimi për kosovarët.
- KAEF krenohet me përkrahjen e fuqishme të bizneseve kosovare.

KAEF është katalizator i zhvillimit të qëndrueshëm të Kosovës demokratike, ngase kosovarëve të motivuar, talentuar, me aftësi udhëheqësie u ofron bursa për magjistraturë në universitetet elite të SHBA-ve. Me t'u kthyer në Kosovë, studentët e diplomuar të programit KAEF, i synojnë pozitën udhëheqëse në organizatat private dhe ato publike, duke synuar që të jenë udhëheqës në shoqërinë kosovare – si individ apo edhe pjesë e një shoqërie në rritje.

KAEF ka dy qëllime: njëri është urgjent, dhe tjetri i domosdoshëm. Qëllimi urgjent janë vetë Bursistët e KAEF-it – të rinjtë e talentuar që u mungon mundësia e vijimit të edukimit në universitetet më me renome që ekzistojnë në SHBA. Programi synon që këtyre studentëve t'u ofrojë shkollim të avansuar në fushat përkatëse për karrierat e tyre si udhëheqës të ardhshëm të Kosovës.

Qëllimi i domosdoshëm i KAEF-it janë vetë institucionet kosovare: ministritë, bizneset, organizatat jo fitimprurëse, agjensitë donatore, korporatat ndërkombëtare, mediat, parlamenti, gjykatat – shkurt, të gjitha institucionet që e mbajnë shoqërinë kosovare. Duke sjellur edukim intensiv dhe kualitativ udhëheqësve të ardhshëm, KAEF do të ndikojë në marrjen e reformave të nevojshme për Kosovën, në mënyrë që burimet natyrore dhe njerëzore të Kosovës të shfrytëzohen në mënyrë të duhur për ndërtimin e demokracisë së qëndrueshme, stabile dhe të pavarur.

Me fjalët e tyre

Luan Dalipi

Monterey Institute of International Studies



“Kosova ka nevojë për vazhdimësi suksesesh biznesi për t'i ikur një herë e përgjithmonë imazhit të vendit të pas-lufte me mundësi të kufizuara për investime. Kosovarët që posedojnë nivelin e masterit në administrim të biznesit në të ardhmen e afërt do të jenë Ambasadorët e Biznesit Kosovar për pjesën tjetër të botës. Nëpërmjet investimeve dhe krijimit të vendeve të reja të punës, Kosova do ta sigurojë stabilitetin ekonomik, dhe me stabilitetin ekonomik stabiliteti politik do të forcohet.”

Edona Pacarada

George Washington University



“Kthimi në Kosovë dhe të qenit pjesë e ekipit që i është besuar misioni i promovimit të zhvillimit të ekonomisë së qëndrueshme kërkon kuptueshmëri të gjërë të çështjeve të biznesit dhe faktorëve të tjerë të përfshirë në proces - shoqëror, politik dhe ndërkombëtar. Unë fuqimisht besoj se programet e ofruara nga universitetet e nivelit të lartë, nëpërmjet programit të KAEF-it, do të më sigurojnë mua me pasqyrën teorike dhe aftësitë praktike, të nevojshme për të sjellur kontribut të dukshëm në ambientin e biznesit kosovar.”

Dastid Pallaska

Yale University



“Rritja në një dekadë ndryshimesh dhe trazirash konstante me ka bërë që ta kuptoj rëndësinë e udhëheqësisë së mirë dhe të pasojave që vijnë në mungesë të saj. Kjo situatë, në fakt, ishte ajo që ndikoi në vendimin tim që të mos qëndroj me përtaci pranë proceseve që ndikojnë në të ardhmen e shoqërisë sime, por të merrem me to proaktivisht.”

To learn how you can help, visit www.kaef-online.org



Një mundësi edukimi për gjeneratën e ardhme të udhëheqësve kosovarë

Në përkrahje të KAEF-it

Ju lutemi që edhe ju ta konsideroni përkrahjen tuaj ndaj KAEF-it, përkrahje që është në rritje nga bizneset, fondacionet dhe individët që e përkrahin misionin e KAEF-it.

Ju mund të ndihmoni duke:

- **Kontribuar** – me çfarëdo shume – për programin KAEF
- **Lobuar** në emër të programit
- **Njoftuar** stafin e KAEF-it me donatorë të mundshëm

KAEF-i është krenar me përkrahjen e mundësuar nga:



OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU S.H.A.
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRZISTA A.D.



Njoftohuni me bursistët e KAEF-it

Bursistët e Fondit Kosovaro-Amerikan për Edukim (KAEF) studiojnë në universitetet prestigjioze të SHBA-ve dhe kthehen në Kosovë për t'u bërë liderë në sektorin publik dhe atë privat të Kosovës. Nga viti 2004, KAEF ka ofruar 39 bursa për kosovarët e rinj. Më poshtë mund t'i shihni 39 bursistët e KAEF-it dhe universitetet e tyre.

- Artan Ajazaj** — George Washington University
Seb Bytyqi — Indiana University
Vllaznim Bytyqi — University of Delaware
Fortuna Haxhikadrija — Duke University
Teuta Kacaniku — Tufts University
Edmond Mjekiqi — Duke University
Aleksandar Radic — Rochester Institute of Technology
Artan Tigani — Rochester Institute of Technology
Luan Dalipi — Monterey Institute of Intl. Studies
Rhedon Begolli — Monterey Institute of Intl. Studies
Gëzim Gjikolli — Bowling Green University
Lulëzon Jagxhiu — Pennsylvania State University
Besa Luci — University of Missouri at Columbia
Valbona Shujaku — Columbia University
Nebojša Vlajic — University of Montana
Dastid Pallaska — Yale University
Diell Bakalli — Monterey Institute of Intl. Studies
Krenar Bujupi — College of William & Mary
Nita Gojani — Johns Hopkins University
Valdrin Lluka — University of Minnesota
Edona Nahi — Monterey Institute of Intl. Studies
Edona Paqarada — George Washington University
Emira Talović — University of Missouri at Columbia
Jetemir Balaj — Harvard University
Granit Berisha — Monterey Institute of Intl. Studies
Blerta Berveniku — College of William & Mary
Dita Bytyci — Rochester Institute of Technology
Kujtim Gazideda — Monterey Institute of Intl. Studies
Ljubisa Mijacic — Cleveland State University
Zana Rudi — Harvard University
Selim Selimi — Duke University
Albina Berisha — Monterey Institute of Intl. Studies
Azemine Demiri — Willamette University
Njomza Rexhepaj — University of North Alabama
Pleurat Halili — Columbia University
Biserka Ivanovic — University of Missouri at Columbia
Artan Mehmeti — Bowling Green University
Rrezarta Veseli — Rutgers University
Arianit Osmani — George Washington University

To learn how you can help, visit www.kaef-online.org